

Në qoftë se do të kërkohej një krijim letrar që t'i përshtatej plotësisht shprehja "vepër monumentale", vështirë se do të gjendej shembull më i mirë se *Rrethimi i Shkodrës* i Marin Barletit.

Ismail Kadare¹

Questions on the study of different editions of Marin Barleti's works.

Abstract: *Critical editions of early Albanian literature works constitute interesting topics as to the study of text patterns reverberating with them. There is a consolidated tradition of the study of the authors who published liturgical and pocket prayer books and catechism booklets in the 16th-18th centuries. Of no less importance are the authors who published in Latin, as their works are ranked among the most important with reference to the history of the early Albanian literature. From this viewpoint, the works of Marin Barleti as well have come into the focus of specific in-depth studies, with rich commentaries and footnotes. The translations and the various adaptations of Barleti's works bear witness to the importance that they represent for Albanologists.*

Keywords: *Renaissance humanist literature, historiography, critical editions, early Albanian literature, the art of writing.*

Botimet kritike që disponojmë sot e kësaj dite mbi veprat themelore të letërsisë së vjetër shqipe përbëjnë burime të rëndësishme që na orientojnë ndaj konsultimit më të përafuar me përmbajtjen e këtyre veprave, duke mbetur njëkohësisht dhe një mjet ndërgjegjësimi mbi rëndësinë që paraqet pajisja me një aparat të shëndoshë kritik në shumë pikëpamje e botimeve të këtyre veprave, duke bërë të mundur reflektime mbi shumë aspekte dhe elemente, mbi të gjitha ndaj leksikut dhe hollësive që dalin në pah pikërisht

1 *Rrethimi i Shkodrës*, (përktheu H.Lacaj); përgatiti për botim D.Hosaflook, Botime Onufri, Tiranë, 2012.

nga studimi i tekstit në formatin e botimit kritik e filologjik, gjithashtu dhe mbi dukuri të tjera që kanë të bëjnë me nënsisteme specifike gjuhësore, por dhe me qasje me vepra të përafërta në kohë dhe të ngjashme në përmbajtje. Po cekim dhe në këtë rasë çështjen e vlerësimit që duhet t'i japim përherë dhe disponimit të botimeve kritike dhe filologjike mbi këto vepra dhe mbi këtë periudhë specifike të zhvillimit të shkrimit shqip, duke qenë se kemi objekt trajtese dhe një tjetër natyrë të përgatitjes së një vepre për botim e që ka të bëjë me realizime që në pikëpamje kronologjike afrojnë me veprat e letërsisë së vjetër shqipe, por janë shkruar së pari në një tjetër gjuhë dhe parashtrajnë të tjera kërkesa në pikëpamje të realizimit për botim dhe pajisjes me nota dhe shpjegime që domosdoshmërisht përbëjnë një ezigjencë kur bëhet fjalë për t'u thelluar më konkretisht dhe më bindshëm ndaj përmbajtjes së veprës. Vetë personaliteti dhe biografia e autorit të *Rrethimit të Shkodrës* dhe të *Historisë së jetës dhe bëmave të Skënderbeut* ka qenë jo rrallë objekt i një kërkshërie shkencore që paraqitet konsekuente e ky fakt është dëshmuar nga kërkimet e vazhdueshme, nga vetë ribotimet në disa gjuhë të këtyre veprave, por dhe nga reflektimet e biografëve, historianëve, medievalistëve, kërkuesve që kanë pasur objekt studimi historinë e viseve ballkanike në mesjetën e vonë, ngjarjet historike që kanë të bëjnë dhe me viset tej Adriatikut, të përfshira në një sërë marrëdhëniesh tregtare, ekonomike, politike dhe diplomatike me Arbërinë dhe principata apo organizime të tjera kufitare. Në shumë pikëpamje, veprat e Marin Barletit ofrojnë një panoramë mjaft me interes për studimet tona, duke konsideruar në plan të parë dhe prospektin e gjerë të një shtate historike të ndërlikuar e që ka gëzuar dhe vëmendjen e rrëfimtarrëve të kohës, më në veçanti në gjuhë të tjera, të cilët kanë përjetësuar në mënyrën e tyre ngjarje që lidhen me *Rrethimin e Shkodrës* dhe me qëndresën e banorëve të një prej fortesave më të rëndësishme për viset arbërore. Sjellja e tyre në gjuhën shqipe nuk duhet të ketë qenë e lehtë për një sërë arsyes, ndër të cilat dhe perspektiva që një vepër e këtyre përmasave dhe e një përmbajtjeje kryesisht historike, por që ruan përmasat e narracionit, duhet pasqyruar në elemente të përmbajtjes, në elemente të leksikut, në elemente të qytetërimeve dhe kulturave që janë pjesë e këtij korpusi tregimtar e që kanë kushtëzuar autorin e vetë veprave në fjalë në të dyja rastet. Të shkruara në një gjuhë *par excellence* kulture për kohën, të përpiluara prej autorit të tyre në kushtet e domosdoshmërisë për të vënë në qendër të vëmendjes një figurë historike dhe legjendare si ajo e Kastriotit, apo dhe një ngjarje që kapërcen përmasat e përshkrimit të një beteje apo ndeshjeje episodike mes popujsh dhe kulturash, të dyja veprat e Barletit përbëjnë objekt të pashtershëm kërkimi në shumë pikëpamje. Një element fare i vogël në dukje, por që dëshmon angazhimin e shqipëruesve të veprave të këtij autori mbetet një shënim që vendos studiuesi Stefan Prifti në një

variant të shqipërimit të *Historisë së Skënderbeut* dhe që në të vërtetë është një prej detajeve që jep të kuptosh sa përfshirës bëhet ky proces për vetë përkthyesin dhe studiuesin e veprës, duke qenë se Prifti mbulonte të dyja këto kompetenca në veçanti kur merrej me përgatitjen për botim të variantit në gjuhën shqipe të kësaj vepre.²

Përgatitja për botim e këtyre veprave kërkon domosdoshmërisht njohjen specifike të një konteksti po aq të veçantë e që ka të bëjë dhe me mundësinë e qasjes me botime *ad hoc* mbi autorin dhe periudhën në fjalë, mbi gjendjen administrativo-shtetërore të organizimit të bashkësive qytetare të banorëve, marrëdhëniet mes shteteve dhe interesat që bëheshin më konkrete kur në qendër të vëmendjes viheshin qytet-kështjellat e kohës, të vëna përballë presionit a rrezikut të fuqive më të mëdha të asaj kohe. Këtyre fakteve njohja e një periudhe më të veçantë të gjuhës latine e që dallon në disa elemente nga ajo klasike, u jep përfundimisht parametrave të sipërpërmendur një status më të kuptimtë, duke përbërë në të vërtetë dhe një *conditio sine qua non* në pikëpamje të realizimit të një botimi sa më të arrirë e sa më funksional për të interesuarit më të afërt ndaj brendisë së veprave të Marin Barletit. Botimet e mirëfillta kritike të këtyre veprave u shërbejnë njëkohësisht disa drejtimeve studimore, ndër të cilat pikërisht ato historike me perspektivë të qartë ndaj mesjetës së vonë shqiptare kanë një vend parësor.³

Jashtë diskutimit që duhet bërë sa i takon paraprirjes në kohë të botimeve të veprave të tjera mbi argumente të ngjashme të trajtuara nga Barleti dhe mbi të cilat nuk ndeshim përkime pikëpamjesh dhe bindjesh nga ana e historianëve dhe studiuesve të kohës, vetë përpilimet e Barletit nuk kanë humbur akoma interesin e vëzhgimit pikërisht në pikëpamje historike, fakt që e dëshmon dhe nënvizimi dhe tërheqja e vëmendjes në ditët e fundit mbi ekzistencën e një varianti në dorëshkrim që nuk njihej mbi *Rrethimin e Shkodrës* e që pret të bëhet i njohur në pikëpamje brendie e të vlerësohet në pikëpamje kronologjie dhe realizimi nga studiues të autorit dhe kohës së tij. Një autor si Barleti është bërë përherë objekt vëmendjeje në botime

2 Shih në veçanti Barleti M., *Historia e Skënderbeut, (përkthimi nga orgjinali latinisht dhe hyrja nga Stefan Prifti), botim i dytë*, Tiranë, 1967, f.78, përkatësisht shënimin në fund të faqes të Stefan Priftit në lidhje me termin *përdredhore*: Kështu kemi përkthyer fjalën “tormentum”, që tregonte një armë predhahedhëse, që njihej qysh në kohën e romakëve. Kemi krjuar këtë term të mbështetur në ngjashmërinë kuptimore, për t’iu larguar përdorimit të fjalës “top”, e cila është tepër anakroniste.

3 Duke konsultuar trajtesa që lidhen drejtpërdrejt me shkrimtarinë e Barletit dhe me sprovat që janë bërë për ta sjellë veprën e tij në disa gjuhë të Evropës, del qartë që nga një botim në tjetrin ka ndryshime që shfaqen që në elementet tekstore më domethënëse e që kanë të bëjnë dhe me letrat dedikatore që tradicionalisht u paraprinin shtjellimit të përmbajtjes kur botoheshin a realizoheshin të tilla vepra. Shih në veçanti kreun me titull *Edizioni, traduzioni e rimaneggiamenti* në Pall F., *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucaresti, 1938, f.17-27.

mbi historinë e letërsisë sonë të shkruar dhe ka përfaqësuar një zë më vete e jo pa rëndësi në përbërje të një plejade veprash e botimesh të një periudhe të përafërt kohore.⁴ Janë pikërisht shqipërimet dhe variantet e tyre që e kanë përafëruar këtë autor me studimet tona dhe reflektimet mbi domosdoshmërinë e thellimit në këndvështrime dhe filologjike të brendisë së veprave që ai ka përpiluar. Botimet e veprës *Rrethimi i Shkodrës (De obsidione Scodrensi)* mbeten gjithashtu një mundësi për të shqyrtuar e riparë pozicionimin e vetë autorit ndaj ngjarjes në vetvete, por dhe elemente të tjera që gjinden që në notat hyrëse të veprës, dedikimit që e bëri të njohur atë vetë dhe që ndërmendet që në titull të saj, gjithashtu dhe pjesë të veprës të cilat mund të bëhen objekt qasjeje në pikëpamje ndërtimi dhe formati me të tjera pasazhe të ngjashme në botime të kohës.

Duke konsultuar variantin në gjuhën latine të njërit prej botimeve të kësaj vepre, mund të vihet re fare mirë që për emërtime të caktuara, për emra personazhesh, për elemente të një nomenklature specifike që ka të bëjë dhe me organizimin e një fuqie që përfaqëson të huajt dhe njëkohësisht agresorët e ardhur nga vende të tjera, autori jep trajta të përshtatura, apo të përafërta me ato që njihen e përdoren dhe në dokumentacionin ekzistues për kohën në të cilën zhvillohen ngjarjet e përshkruara. Që në titullin e veprës dhe në përmbajtjen e lëndës, që në faqet e para të cilave autori u ka rezervuar një natyrë sa deskriptive, aq dhe analitike e që meritojnë me të drejtë një analizë të hollësishme historike, duhet receiptuar ideja që ai transmeton për njërën nga fuqitë më të mëdha të kohës. Dhe pse ndërmenden në vise të ndryshme të këtij botimi emërtesa garnizonesh, njësi të veçanta të një ushtrie të mbiorganizuar dhe gjithashtu të stërmadhe në pikëpamje forcash të rekrutuara, është krejt e qartë që kundërshtari për autorin është vetë Sulltani i quajtur në mënyrë permanente nën një sërë emërtesash që e dallojnë qartë nga pjesa tjetër e ndjekësve të tij. Atributet që i vishen kësaj figure që në të vërtetë është dhe më e motivuara për të shpënë deri në fund rrethimet e gjata dhe të vështira që mbetën në kujtesën e një kombi dhe të mjaft vendeve të tjera në Ballkan dhe Evropë, bëjnë të kuptosh se e tija ishte sfida më e madhe në këtë ndeshje që vë përballë kultura dhe qytetërime të ndryshme, të largëta në pikëpamje afrie dhe mundësie përqasjeje.

Çdo lexim i kujdesshëm i varianteve ekzistuese në gjuhën shqipe që janë një tjetër perspektivë e mundësisë për ta lexuar dhe brendësuar vizionin e një autori humanist si Barleti ndaj ngjarjeve dhe figurave të sipërpërmendura, vetiu bëhet shtysë për të reflektuar mbi variantin më të përshtatshëm dhe më të mirë të mundshëm e që të jetë funksional në disa pikëpamje. Botimet e njohura deri më tani të veprës *Rrethimi i Shkodrës* përbëjnë në vetvete kontribute dhe në pikëpamje të sprovimit për ta sjellë

4 Shih në veçanti botimin me titull *Historia e letërsisë shqipe I*, Tiranë, 1959, f.165 v.

më afër autorin dhe përmbajtjen e saj. Lehtësimi i të kuptuarit të një sërë elementesh, qofshin dhe ubikimet gjeografike që mbeten hollësi themelore në drejtim të vlerësimit të saktësisë së trajtesës së autorit, bëhet i mundur dhe nga vetë natyra e botimit që ndërmerret duke pasur qëllim përafrimin e veprës së Barletit. Në pikëpamje teknike dhe të ndërtimit të elementeve që e përbëjnë tërësinë e çdo varianti, mund të vërehet fare qartë që mes botimeve dhe ribotimeve të veprave të Barletit në gjuhën shqipe ka ndryshime që mund të shpjegohen në mënyra të ndryshme. Parathëniet e veprave të tij janë kujdesuar nga historianë apo filologë, njëkohësisht dhe njohës të mirë të një periudhe specifike që përfshin dhe Marin Barletin si autor. *Rrethimi i Shkodrës* i shqipëruar në një mënyrë mjeshtërore nga Henrik Lacaj tradicionalisht njihet përmes botimesh a ribotimesh të paraprirra nga parathënia e Aleks Budës, me shënime që vendosen ndaj elementesh që kanë të bëjnë me fusha të ndryshme semantike e jo vetëm me emërtesa të përveçme që i referohen një personi apo një kategorie personale. Konkretisht, vendosja e shënimeve në fund të vëllimit përkatës (Marin Barleci, *Rrethimi i Shkodrës, botim i dytë i shtuar*, Tiranë, 1967) nuk e lehtëson shumë procesin e konsultimit të shënimeve të caktuara që lidhen herë me armatimet e ndërmendura, herë me risitë në fushë të organizimit të ushtrisë otomane, herë me shpjegime që kanë të bëjnë me fortifikime dhe me elemente të tjera që në botimin e vitit 2012 janë plotësuar dhe nga të tjera nota që u referohen dhe pasazheve të shkurtra nga pjesë të veprës e që kanë referencë të qartë biblike. Botimi i vitit 2012 i veprës *Rrethimi i Shkodrës* bie në sy për pajisjen me më shumë se një parathënie, për një vëmendje të spikatur ndaj elementit historik që përshkon veprën e që përforcohet më tepër nga prania e hartave dhe e medimeve të tjera që i vijnë në ndihmë brendësimit të veprës nga ana e lexuesit. Theksohet në të dhe parathënia e Aleks Budës, duke u pajisur dhe me shënime që sqarojnë më mirë vështirësitë e këtij të fundit ndaj elementeve të veprës, periudhës dhe vetë autorit. Botimi i sipërcituar shënon pa dyshim një hap të mëtejshëm ndaj konsiderimit të një mundësie më të mirë për ta lexuar dhe brendësuar përmbajtjen e veprës së Marin Barletit dhe në këtë drejtim dhe një aparat teknik që plotëson dhe mbështet shtjellimin e tekstit veç i vjen në ndihmë kësaj çështjeje. Nga ana tjetër, shënimet që dhe në rastin e kësaj vepre janë më se të domosdoshme, janë vendosur më afër vetë tekstit, duke u bërë e mundur të konsultohen drejtpërdrejt dhe për më tepër dhe me të tjera plotësime që kanë lidhje me fjali e shprehje të caktuara e që qëndrojnë më së miri me përmbajtjen në fjalë. Këto të fundit nuk përmbahen në botimet e mëparshme të veprës *Rrethimi i Shkodrës* dhe shprehin në njëfarë mënyre dhe qëndrimin e vetë kujdesuesit të këtij botimi ndaj brendisë së veprës dhe pasazheve konkrete të saj. Botimi më i fundit në gjuhën shqipe (Tiranë, 2012) i *Rrethimit të Shkodrës* të Marin Barletit në shumë

elemente diferencohet nga variantet e mëparshme që njohim e ndërkohë nuk shterron mundësitë për ta risjellë më vonë veprën e sipërpërmendur dhe në një vështrim që duhet të ketë në krah variantin përkatës në gjuhën latine, pikërisht atë të vitit 1504, që dhe konsultohet lehtë në formatet me të cilat disponohet në bibliotekat ku ruhet.⁵ Mbetet ky një argument që na shpie dhe drejt reflektimesh mbi aspekte të ndërtimit të variantit të vitit 1504, ndër të cilat këtu do të ndërmendnim dhe inkoherencat që bien në sy gjatë leximit të tekstit e që kanë të bëjnë me emra të përveçëm, me emra vendesh të caktuara, ndaj të cilave autori ose kush e ka ndjekur veprën në proces të shtypit nuk është treguar përherë i vëmendshëm. Studimet që marrin parasysh sa është koherent autori i këtyre veprave me faktet e përshkruara, sa mund të jetë i familjarizuar me rrethanat që shtjellohen si në *Rrethimin e Shkodrës*, ashtu dhe në veprën mbi jetën dhe bëmat e Skënderbeut, gjejnë konfirmim dhe në vështrimin tekstologjik që mund t'u bëhet aspekteve të shkrimit të emrave të personazheve, ubikimit të vendeve të caktuara e që në të vërtetë janë një pikë delikate në pikëpamje të gjykimit të saktësisë së të shprehurit të autorit.⁶

Studimet mbi Marin Barletin dhe veprat e tij zakonisht kanë marrë parasysh dhe një dokumentacion të pasur që lidhet si me periudhën, si me personalitete që kanë luajtur rol të rëndësishëm për kohën dhe që evidentohen si të tilla në materiale arkivore që dëshmojnë fakte të njohura apo dhe të trajtuara te Barleti. Marin Barleti mbetet një prej burimeve ndaj të cilave bie në sy një referim i vazhdueshëm nga ana e mjaft studiuesve e në veçanti historianëve.⁷

5 I referohemi në veçanti botimit më të fundit kritik të veprës së Barletit, pikërisht asaj me titull *Rrethimi i Shkodrës (përktheu H.Lacaj); përgatiti për botim D.Hosaflook*, Botime Onufri, Tiranë, 2012. Shih po aty dhe parathënien me titull *Sfondi historik i rrethimit të Shkodrës, përgatitur nga David Abulafia, përkthyer nga Arben Bushgjokaj*, f.1-8. Shih gjithashtu *Hyrje (Aleks Buda, 1967), po aty, botim i cituar*, f.9-33.

6 Të tilla të dhëna mund të vilen që në indeksin analitik të lëndës së veprës *De obsidione Scodrensi*, në variantin latin të vitit 1504, në të cilin evidentohen jo vetëm informata mbi përmbajtjen e saj, por dhe mund të gjurmohen disa inkoherenca të lehta në pikëpamje të shkrimit të emrave apo mbiemrave të personazheve të caktuara, si dhe të ndonjë toponimi që përshkruhet më tej në vepër.

7 Për një trajtim të thelluar në pikëpamje të biografisë, personalitetit dhe aspekteve themelore të ndërtimit të veprave të Barletit mbetet përherë për t'u konsultuar botimi studimor me titull *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucaresti, 1938, i autorit F.Pall. Në krerët e kësaj vepre trajtohen çështje të rëndësishme që lidhen me reflektimin e ngjarjeve të kohës në personin e Barletit dhe në vetë veprat e tij, shkalla e njohjes nga ana e tij e rrethanave të caktuara të ngjarjeve që përshkruhen në këto vepra; analizohen gjithashtu pjesë të caktuara nga këto vepra duke u parë në vështrimin kritik dhe folologjik, në mënyrë që të dalin në pah dhe ndikime jo të pakëta nga autorë të periudhave të klasicitetit të hershëm latin. Francisc Pall do t'i rikthehet në një sërë studimesh personit të Barletit dhe verifikimit të të dhënave me vlerë historike që mund të vilen dhe konsiderohen në veprat e tij. Shih ndër të tjera dhe Pall F., *I Rapporti*

Sjellja e veprave të Marin Barletit në variante botimesh kritike të pajisura me një sërë indicesh si parathënia e pasuruar me shënime të natyrës historike, por dhe filologjike e letrare, interpretime që lidhen drejtpërdrejt me përmbajtjen e librave të tij, plotësime që orientojnë ndaj elementesh që ndeshen në botime të tjera dhe në gjuhë të tjera të veprave të tij, veçimi me anë mjetesh teknike e me qëllim të nënvizimit nga pikëpamja e rëndësisë e ligjëratave që përmbahen në të e që bëjnë të jenë aktorë personalitete të ndryshme të kohës, janë të gjitha hollësi që risjellin në vëmendje dhe rëndësinë e çdonjërit prej botimeve dhe dobinë e kriterëve që janë zbatuar në realizimin e tyre. Edhe *Rrethimi i Shkodrës* është një vepër në të cilën shkruhen faqe të tëra mbi prijesin arbër që ishte pjesë e një mozaiku sa historik, aq dhe legjendar (Gjergj Kastriotit), duke nënvizuar rolin e qëndresës së tij në ruajtjen e integritetit të qytet-kështjellave të viseve arbërore. Pjesë të rëndësishme nga kjo vepër, në të cilat shihet qartë motivimi i autorit për të përshkruar fortesat e Arbërit si simbol qëndrese dhe ndërkohë dhe të favorizuara nga natyra e relievit dhe konfigurimi shkëmbor rrethues, janë njëkohësisht më të përshtatshmet për t'u bërë objekt studimi dhe për t'u plotësuar me shënime e sqarime. Përshkrimet e Barletit nuk janë aspak indiferente ndaj një lidhjeje të qartë mes qyteteve që u bënë pjesë e kësaj historie e një fakt i tillë dëshmohet dhe nga përshkrimi që ai i bën Krujës që nuk u mposht për vite me radhë e që ndërmendet dhe në këtë vepër për rezistencën që u bëri sulltanëve më të egër për kohën.⁸

italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV (Documenti inediti con introduzione e note storiche-critiche), Estratto dall'Archivio Storico per le Province Napoletane, Terza serie, Vol.IV, Società Napoletana di storia patria, Napoli, 1966.

- 8 Barleci M., *Rrethimi i Shkodrës, përkthye prej origjinalit latinisht nga Henrik Lacaj, botim i dytë i shtuar*, Tiranë, 1967, f.48-49: Për pozicionin e qytetit të Krujës dhe për themeluesin e saj do të flas fare shkurt, me sa kemi mundësi të dijmë sot. Kruja asht një qytet i Shqypnisë, kështjellë shumë e fortë dhe një çels fare i sigurtë i asaj krahine. Rrethin kështjella nuk e ka të madh, por ajo qëndron mbi një shkamb shumë të naltë edhe nga të katër anët bie thik; rreth e përqark ka fusha të mëdha: në ato fusha luftoi Cezari kundër Pompeut. Kjo kështjellë nuk mund të sulmohet, as mund të shtihet në dorë në asnjë mënyrë, sepse çdo anë e ka fortifikue natyra, edhe dora e njeriut me mjeshtri të madhe. Aty ka kroje të begatshme e të pashterrshme, bile emnin e ka marrë pikërisht prej këtyne, sepse në gjuhën shqipe krue d.m.th. burim. Fushat i ka shumë pjellore e të bukura, po edhe pyjet (simbas mendimit tim) i ka ma të hieshme e ma të frytëshme së në çdo vend tjetër; druajt e atyne pyjeve (sikurse thonë disa) askund nuk i gjen ma të gjatë e ma të përshtatun për ndërtimin e anijeve. Kruja gjndet larg Durrësit katërmëdhjetë mil e larg Shkodrës pesdhjeteshtatë mil dhe, me qenë se ky qytet ishte pranë kufijve të Turqve, këta, mbasi vdiq i pathyeshmi princ, Skanderbeu, që e kishte në zotnim, zunë të ngasin vazhdimisht. Sa qe gjallë Skanderbeu, dy Sulltanë u përpoqën m'e rrethue Krujën me sa fuqi patën, por u shkoj mundimi kot sepse Skanderbeu u bani ballë me trimëni jashtëzakonisht të madhe e qysh prej asaj kohe, sa qe gjallë Skanderbeu, s'ia mbajti asnjë ushtrie turke të hynte në Shqipni dhe (si të

Çdonjëri prej botimeve të veprave të Marin Barletit, sido të paraqiten në sytë tanë në pikëpamje të thjeshtësisë së përgatitjes apo pajisjes me elemente shpjegimi, mbart veçanti dhe hollësi tekstore për t'u bërë objekt vëmendjeje e vëzhgimesh. Në të vërtetë disponimi i jo pak varianteve të botimit të veprave të Marin Barletit bën të mundur të shtrohen disa pista qasjesh dhe krahasimesh, qoftë dhe në drejtim të punës së përgatitësve të botimeve në fjalë. Mbi të gjitha duhet nënvizuar që të tilla variante janë një dëshmi e qartë e vëmendjes që gëzoi në periudha të caktuara të zhvillimit të dijes së albanologjisë dhe ky autor humanist, përherë objekt kërsërie dhe shtysë për kërkime të mëtejme.

BIBLIOGRAFI

- Baldacci A., *Di un importante studio su Marino Barlezio*, në *Dalmatica*, maj 1940.
- Bardhi F., *Skënderbeu (Apologji)*, (përktheu nga latinishtja Stefan I.Prifti), Tiranë, 1967.
- Barleti M., *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, (përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga S.J.Prifti), Tiranë, 1964.
- Barleti M., *Historia e Skënderbeut*, (përkthimi nga origjinali latinisht dhe hyrja nga Stefan Prifti), botim i dytë, Tiranë, 1967.
- Barleti M., *Historia e Skënderbeut*, (botim i tretë, përkthyer nga S.I.Prifti), Tiranë, 1982.
- Barleti M., *Historia e Skënderbeut, Libri XI, Botimi IV, shqipëroi Stefan Prifti*, Infbotues, Tiranë, 2005.
- Barleti M., *Rrethimi i Shkodrës, përkthye prej origjinalit latinisht nga H.Lacaj*, Botimi i dytë i plotësuar, Tiranë, 1967.
- Barleti M., *Rrethimi i Shkodrës (përktheu H.Lacaj); përgatiti për botim D.Hosaflook*, Botime Onufri, Tiranë, 2012.
- Ceka H., *Vërejtje mbi disa të dhana topografike rreth luftave të Skënderbeut sipas Barletit*, Buletin për Shkencat Shoqërore, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952.

thom) ta pushtonte. Ma parë Krujën e pat sulmue me të gjitha ushtritë e veta Murati, i ati i Mehmetit, e me qenë se nuk i doli kurrsesi m'e shti në dorë, nga zemrimi e mllëfi i fortë vdiq.

- Kamsi W., *Rrethimi i parë i Shkodrës(1474)*, në *Buletin Shkencor i Institutit Pedagogjik të Shkodrës*, n.7, 1968.
- Marlekaj L., *Scanderbeg nelle tradizioni popolari albanesi*, Bari, 1969.
- Nadin L., *Migrazioni e integrazione: il caso degli Albanesi a Venezia(1479-1552)*, Bulzoni editore, Romë, 2008.
- Nadin L., *Albania ritrovata. Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto*, përktheu Pëllumb Xhufi, Botime Onufri, Tiranë, 2012.
- Nadin L., *Religiosi albanesi nelle terre della Serenissima tra Quattrocento e Cinquecento: uno scenario di incredibile ampiezza, tra storia di chiese e storie di arte*, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2013.
- Nadin L., *Marino Barlezio tra Venezia, Padova, Vicenza. Paesaggi veneto-scutarini*, në *Shëjzat-Pleiades*, n.1-2, 2016.
- Pall F., *Marino Barlezio, uno storico umanista*, Bucaresti, 1938.
- Pall F., *I Rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV (Documenti inediti con introduzione e note storiche-critiche)*, Estratto dall'Archivio Storico per le Province Napoletane, Terza serie, Vol.IV, Società Napoletana di storia patria, Napoli, 1966.
- Pall F., *Di nuovo sulle biografie scanderbegiane del XVI secolo*, në *Revue des études sud-est européennes*, n.1, 1971.
- Pipa A., *Umanisti italo-albanesi*, në *Albanica, Numër special*, 1992.
- Plasari A., *Skënderbeu, një histori politike*. Instituti i Studimeve Shqiptare "Gjergj Fishta", Tiranë, 2010.
- Plasari A., *Shqipëria dhe shqiptarët në Europën e Piut II*, IDK, Tiranë, 2014.
- Petrota G., *Popolo, lingua e letteratura albanese(a cura di M.Mandalà)*, Edizioni Mirror, Palermo, 2003.
- Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932.
- Sirdani M. O.F.M., *Skanderbegu mbas gojdhânash*, në *Zâni i Shna Ndout*, n.III, 1920.
- Sirdani M. O.F.M., *Kerkime mbî vorrin e Skanderbegut*, në *Hylli i Dritës*, n.4, 1932.
- Sirdani M.O.F.M., *Nji rival i Skanderbegut*, në *Hylli i Dritës*, n.7-8, 1932.
- Sirdani M. O.F.M., *Kontribut për historinë e kulturën shqiptare*, Botime Françeskane, Shkodër, 2017.

- Zamputi I., *Lezhja, Rodoni, Durrësi dhe përpjekjet e fundit për rimëkambjen e principatave shqiptare*, në *Studime historike* n.1, 1964.
- Zamputi I., *Gjendja e materialeve dokumentare dhe burime të reja vendase për historinë e Shqipërisë për tre shekujt e parë të pushtimit turk*, në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, n.3, 1955.
- Zamputi I., *Shënime mbi disa aspekte të lëvizjes çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk*, në *Studime historike* n.1, 1965.
- Zamputi I., *Elemente të vetëdijes shqiptare në përpjekjet për liri, për gjuhën shqipe e për arsim në shekujt XVI-XVII*, në *Studime historike* n.3, 1965.
- Zoncada A., *Scanderbeg, Storia albanese del secolo XV*, Milano, 1874.